

Lezhë, më 30.09.2025

## PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.09.2025, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Shtator 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës dhe tre projektvendime

**-Ndue Luli:** Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sipas njoftimit që kemi marrë, sot zhvillojmë mbledhjen e zakonshme të Këshillit Bashkiak për muajin shtator, me këtë rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për dhënien e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Gjon Zef Marku”
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Gusht 2025”
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e kritereve dhe kushteve plotësuese që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë (Faza e Dytë)”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e dytë të vitit 2025”
6. Projekt-Vendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025””
7. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 103, datë 19.12.2024 ”Për miratimin e bursave të nxënësve të klasave të X-ta të arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2024-2025”
8. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 104, datë 19.12.2024 ”Për rishqyrtimin dhe miratimin e bursave të nxënësve të viteve të ndërmjetme, të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, për vitin shkollor 2024-2025”
9. Projekt-Vendim “Për miratimin e akordimit të fondit për shpërblimin e sportistit kampion kombëtar”
10. Projekt-Vendim “Për përdorimin e metodologjisë LOD për alokimin e fondeve për organizatat sportive të shoqërisë civile e miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 211, datë 31.10.2017”
11. Informacion mbi ecurinë e sezonit turistik për plazhet publike të menaxhuara nga Lezha Invest shpk
12. Raport mbi Barometrin Gjiner në Bashkinë Lezhë
13. Të ndryshme

Si dhe sipas njoftimit që ju kemi dhënë, kemi tre projekt-vendime shtesë, dhe konkretisht të treja këto kanë të bëjnë me tërmetin e vitit 2019.

I pari është “Për përcaktimin e strukturës së banimit dhe masës së përfitimit në vlerë monetare për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit, të cilët kanë zgjedhur që ndërtimin e banesave ta bëjnë vetë”.

Projekt-vendimi tjetër, “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 49, datë 07.03.2021 “Për përcaktimin e strukturës së banimit të banesave individuale për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit, të cilët kanë zgjedhur që rindërtimi i banesave të tyre të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 të bëhet nga autoriteti shtetëror i caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave””.

Në mbështetje të këtyre dy projekt-vendimeve shtesë që lexova, është një projekt-vendim i tretë i cili do të mbështetet nga financat e bashkisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025””.

Këto janë projekt-vendimet. Atëherë, kush është dakord me rendin e ditës? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota Pro. Faleminderit.

Fillojmë me projekt-vendimin e parë, që ka të bëjë me dhënien e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Gjon Zef Marku. Kush është dakord për dhënien e mandatit? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 28 vota Pro.

Atëherë, para se të kalojmë te projektvendimi tjetër, le të lexojmë formulën e betimit.

Betohem në nderin tim, se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Lezhë dhe do të punoj me ndershmeri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.

**-Gjon Marku:** Betohem.

**-Ndue Luli:** E gëzofsh mandatin. Zoti Gjon do të jetë anëtar i Komisionit të Shërbimeve Publike. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 2, projekt-vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2025”. Kush është dakord me projekt-vendimin? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 29 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 3, projekt-vendim “Për miratimin e kritereve dhe kushteve plotësuese që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore”.

Në lidhje me këtë projekt-vendim, siç jeni në dijeni, është zhvilluar dëgjesa publike me pjesëmarrjen e aktorëve, të këshilltarëve, të komunitetit të Lezhës. Gjithashtu, edhe në komision

dje, janë diskutuar problematika. Kështu që fjalën e keni ju për pyetje dhe diskutime. Zonja Marku.

**-Alfrida Marku:** Faleminderit për fjalën. Në fakt, kishte ardhur koha që veprimtaria e shërbimit funeral të rregullohej, pra të parashikohej dhe të miratohej një rregullore përkatëse, sepse të gjithë e dimë se ankesat e qytetarëve kanë qenë të shumta. Unë gjej rastin këtu që të shpreh konsideratën edhe për të gjithë përfaqësuesit e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shërbimit funeral, sepse në dëgjuesën që u zhvillua pikërisht për të diskutuar në lidhje me këtë rregullore, ata ishin bashkëpunues dhe mirëkuptues. Madje, pati nga ana e tyre dhe sugjerime përkatëse për të bërë ndryshime në këtë rregullore. E kam lexuar projektin e paraqitur nga Bashkia Lezhë dhe siç edhe e kam theksuar në dëgjuesën publike, unë kam një sugjerim që mendoj e bën më të saktë atë që bashkia ka përcaktuar nëpërmjet hartës bashkangjitur rregullores. Unë mendoj që në projekt-rregullore në nenin 4, ku parashikohen kufizimet, duhet specifikuar ajo pjesë e territorit të qytetit të Lezhës, në të cilin ndalohet aktiviteti i shtëpive funerale, që korespondon me hartën që bashkia ka paraqitur, bashkëngjitur projekt-rregullores. Kjo do e bënte më të zbatueshme edhe do e zgjidhte edhe në terren saktësisht të zbatueshme atë çfarë parashikohet në dispozitat e rregullores. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Mendim tjetër? Zonja Sokolaj.

**-Erdhi këshilltari Kristian Gjiodaj.**

**-Regjina Sokolaj:** Të nderuar kryetarë, të nderuar anëtarë të këshillit, sot kemi në rend dite një projekt-vendim me rëndësi të veçantë për komunitetin, miratimin e rregullores që përcakton kushtet dhe kriteret që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të tyre. Ky diskutim nuk është thjesht teknik apo administrativ. Ai prek drejtpërdrejt një nga momentet më të ndjeshme në jetën e çdo familje, përballjen me humbjen e një të dashuri. Prandaj është detyra jonë që të garantojmë që në këto shërbime të ofrohet dinjitet, profesionalizëm dhe standarde të cilat qytetarët tanë natyrisht i meritojnë.

Së pari, rregullorja siguron standarde teknike të domosdoshme. Agjencitë funerale duhet të kenë mjetet e përshtatshme, ambientet e higjenuara, pajisjet e nevojshme për t'i ofruar këto shërbime në mënyrë të sigurt dhe të respektueshme.

Së dyti, vendosen kushte të qarta për burimet njerëzore. Personeli i përfshirë në këto shërbime mundësisht duhet të jetë i trajnuar, i ndjeshëm ndaj situatave dhe të dijë si të veprojë me etikë, kujdes dhe respekt për familjarët në këtë gjendje të vështirë, pra natyrisht ata janë të pikëlluar për humbjen e të afërmeve.

Së treti, kjo rregullore sjell transparencë dhe mbrojtje të qytetarëve. Përcaktimi i kushteve dhe i kriterëve shmang çdo formë abuzimi dhe i jep siguri familjeve në momente të vështira dhe forcon besimin e tyre tek institucionet tona.

Dhe në fund, miratimi i këtij projekt-vendimi siguron përputhshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe standardet evropiane, duke bërë shërbimin funeral një aktivitet të rregulluar, të përgjegjshëm dhe në shërbim të qytetarëve.

Të nderuar kolegë, ky është një hap domosdoshëm për të garantuar që qytetarët tanë edhe në momentet e tyre më të vështira të kenë pranë shërbime dinjitoze, të sigurta dhe me standarde.

Për këtë arsye, ju ftoj të gjithëve që ta mbështesim dhe ta miratojmë këtë projekt-vendim. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit ju. Dua të theksoj se në mbledhjen e sotme, me kërkesë të tyre, kemi dhe dy aktorë të shërbimit funeral dhe të shtëpive funerale. Mirë, mendim tjetër? Po, zoti nënkryetar.

**-Fatjon Zefi:** Në radhë të parë, doja të falënderoja të gjithë subjektet e agjencive funerale që morën pjesë në konsultën publike, edhe këshilltarët gjithashtu. Po do kisha dëshirë që nga ana e këshilltarëve të kishte pjesëmarrje më të madhe. Për sa i përket hartës ne kemi rënë dakord edhe në konsultim publik edhe gjatë komisioneve që ta miratojmë. Harta u është paraqitur të gjithë këshilltarëve. Në qoftë se duhet për ta shpjeguar edhe njëherë, kap qendrën e Lezhës duke u kufizuar me kanalin e Manatisë, Drinin, lagjen e spitalit e përfshin komplet, pra që nuk lejohet, tek Ura e Zezë në lagjen Skënderbeg dhe te karburanti Elda te Gurrat. Kështu që do miratohet e përfshirë edhe harta, zona e kuqe.

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Atëherë, në lidhje me këtë, kishe diçka, zonja Marku?

**-Alfrida Marku:** Se nuk dua të paragjykohe sikur adresoj problemin për subjekte të veçanta, por unë mendoj që harta duhet të shtrihet kudo ku ka zonë urbane të banuar të qytetit të Lezhës. Edhe e dimë që përtej karburantit Elda ka zhvillim, pra ka pallate aty, edhe unë nuk e kam problem ta them. Aty kemi dhe agjenci, ndjesë, shtëpi funerale, që ushtrojnë aktivitetin në pallate të banuara nga familje të Lezhës. Kështu që unë mendoj që harta duhet përshtatur me objektivin për ta zgjidhur problemin në terren.

**-Ndue Luli:** Një sqarim po e jap unë. Ajo hartë e cila është përmirësuar nga dita e dëgjësës publike, duhet të theksoj se kjo hartë nuk ndalon subjektet që të ngrenë agjenci apo shtëpi funerale jashtë kësaj vije, por që të plotësojë të gjitha pikat e nenit 4 të rregullores. Kështu që kjo s'do të thotë që ai që e ka në katin e parë të pallatit do vazhdojë veprimtarinë, sepse nuk përmbush ato pikat e nenit 4.

Fjalën e ka kryetari.

**-Pjerin Ndreu:** Unë jam dakord të kufizohen zonat, po jo deri në ekstremitet. Aty te karburanti mund të shtyhet deri te pallati që është përballë, ai i madhi. Pastaj në zona të tjera duhet të krijohen kushtet ato se edhe në mes të Tiranës ka për shembull të tilla, po ta marrim kështu, por kushtet e organizimit të një shtëpie funerale nuk i japin mundësi kërkujt jashtë që të afektohet. Këto pallatet pastaj duhet të fshihen nga territori. Mund të jetë një godinë jashtë Lezhës dedikuar

për atë destinacion, por me kushtet që mos të reflektohet jashtë. Nuk s'mund t'i mbyllim në të gjitha. Te pallati përballë duhet të fshihet ajo. Në pallate mbrapa pastaj, ne nuk kemi pse hyjmë nëpër zona të ekstremizojmë. Pra, unë jam dakord me përcaktimin e zonave, ku nuk hyhet, ku ka densitet të madh popullore, ku ka pallate, ku ti nuk ke një objekt që mund ta përshtasësh dhe të krijosh kushtet e nevojshme. Nëse s'e ke, atëherë normalisht qyteti nuk ka, nuk të ofron këtë mundësi. S'i ofron qyteti, mund t'i ofrojë një zonë periferike. Nuk e quaj të pamundur.

**-Ndue Luli:** Mendim tjetër, zoti Nderca.

**-Erin Ndreca:** Përshëndetje të gjithëve. Doja të jepja mendimin tim. Edhe unë gjykoj që nëse flasim për miratim kriteresh, i bie që duhet të bazohemi në disa rregulla, në disa akte, në disa ligje. Nëse ne vendosim dhe themi kriteret se atje është një apo atje duhet të jetë një tjetër, jam dakord që duhet t'i marrim parasysh, sepse prandaj jemi këtu. Nuk më duket logjike. Kështu që dhe unë jam i mendimit që ne duhet të vazhdojmë ashtu siç është përcaktuar nga specialistët dhe nga pjesa publike në të cilën është realizuar dhe si projekt-vendim. Prandaj ju ftoj ta votojmë ashtu siç është.

**-Ndue Luli:** Fjala për zotin Marku.

**-Agostin Marku:** Edhe dje në komisione mori vëmendje të veçantë kjo çështje dhe i vetmi problem që edhe ramë në konsensus ishte që te kjo hartë të specifikohen kufizimet dhe të përcaktohen në nen. Çështje të tjera janë pallat, s'janë pallat, i zgjidh rregullorja, ne ndaj e kemi rregulloren për t'i zgjidhur ato dhe kur hyn në fuqi kjo rregullore, bashkia merr masa dhe në qoftë se është në pallat ia kufizon, në qoftë se nuk është në pallat vazhdon dhe pastaj këshillat këtu janë. Zgjerohet zona urbane, ndryshon rregullorja e me radhë. Për kushtet e sotme jemi shumë në rregull me atë rregullore e cila ka dalë edhe nga dëgjesa publike, ka pasë konsensus, edhe nga komisionet, ka pasë konsensus, me të vetmin ndryshim që është çështja të përcaktohen qartë vijat kufizuese sipas hartës që ka sjellë bashkia duke e saktësuar edhe në nen të veçantë. Pra, me këtë ne duhet ta miratojmë. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit ju. Atëherë, fjalën e ka zoti Ndreu.

**-Artan Ndreu:** Përshëndetje të gjithëve. Unë desha të dëgjoj edhe detaje të bashkisë që ka hartuar këtë rregullore, të dëgjojmë edhe këta që kanë konflikt interesi, domethënë biznesmenët, pastaj të japim ndonjë sugjerim. Ju lutem, mos të bëjmë politikë me të vdekurit.

**-Erdhi këshilltari Emirjon Mali.**

**-Pjerin Ndreu:** Është marrë pra parasysh edhe vërejtja që ka bërë zonja apo këshilltarë të tjerë. Janë marrë parasysh, janë reflektuar. Nuk është ai draft që kemi përgatitur ne, por është draft i ndryshuar. Jam dakord që të specifikohet zona, rruga, vendi ku nuk duhet të ushtrohet ky aktivitet për shkak të qenies së kopshteve, çerdheve, shkollave, njërive të përqendruara të banimit, që janë pallatet kryesisht e të tjera, sepse nuk ka një objekt. Në momentin kur dalim jashtë qytetit, ne vetëm nëse i çojmë në breg të lumit, se kudo është zonë e banuar. Shqetësimi

më i madh që kemi marrë ka qenë se ne kemi marrë ankesa nga qytetarët që ka pasur shtëpi funerale në palate. Në mungesë të një rregulloreje, në mungesë të një përcaktimi, ne nuk kemi ditur se si të veprojmë. Tani vetë e kemi ngritur edhe ne kemi rënë dakord se duhet ta adresojmë ne si këshill. Tani jemi për shtëpitë funerale. Ka një specifikë, pastaj të tjerat i rregullojmë mbrapa. Do vijmë edhe për ato. Besoj se ne do diskutojmë edhe një gjë tjetër. Tani ne do të vijmë në këshill me një projekt të cilin do e diskutojmë edhe me të tjerë për të përcaktuar rregullat se si kryhet një varrim dhe për të paguar taksat që ne të ndërhyjmë në këto histori, se nuk ka rrugë tjetër. Ne do dalim edhe me një skemë tjetër. Do mundohemi që të bëjmë një varrezë publike tjetër në zonën Zejmen, Shënkoll, në një zonë ku i kap të dyja njësitë dhe ne do i japim mundësi njerëzve të vijnë te varrezat e bashkisë, jo te varrezat ku i paguajnë me lekë, ashtu siç do mbyllim varrezën në lagjen Nënë Tereza, vihet porta e hekurit. Ne shumë shpejt në këshill miratojmë projekt-vendimin që ajo kalon në varrezë zyrtare, e njohur nga shteti, nga ne bashkia, sepse kështu si është bërë aty ose si është lënë, është një çfarë të them unë, një histori që do zhvillojë më vonë, pra jemi në proces, kemi bërë plan-rivelimin, do i vëmë fre, njëherë do vëmë një derë hekuri këto ditë që njerëzit mos të shkojnë atje të bëjnë çfarë të duan, adresuam njërën, do fillojmë edhe me tjetrën, nuk ka rrugë tjetër ky muhabet, kjo do vu në kontroll tashmë edhe në njësitë administrative edhe në qytet.

**-Ndue Luli:** Mirë, atëherë nga drejtori përkatës, do të na sqaroni se ku janë bërë ato ndryshimet për të cilat kemi folur edhe në dëgjesën publike.

**-Jurgen Marku:** Atëherë, referuar dhe dëgjesës publike që kemi bërë, është konstatuar pjesa e një harte, një kufizimi. Harta është bërë, po ashtu referuar problematikave që ngriti zonja për sa i përket shtëpive funerale në palate, është diçka që është kufizuar te pika 2 e nenit 4 – shtëpitë funerale duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në godina të dedikuara me funksion shërbimi dhe jashtë hartës së kuqe të bashkëngjitur me projektvendimin.

Këto janë ndryshimet që kemi bërë, referuar dhe dëgjesës publike.

**-Ndue Luli:** Atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 30 vota Pro. Këshilltari Kristian Gjiodaj votoi Abstenim.

Projektvendimi u miratua, megjithatë fjalën si aktor e ka përfaqësuesi i biznesit – Emirjan Zefi.

**-Emirjan Zefi:** Siç e kam thënë edhe në dëgjesën publike, e kam mirëpritur këtë projekt rregullorë, jam dakord me të gjitha gjërat, aq më tepër që sot kam dhe garanci kryetarin z. Ndreu, thjesht është që t'i kufizojmë këto shtëpitë funerale sepse një pjesë e mirë janë salla dasme, t'i kemi gjërat me kritere të caktuara, po e njëjta sallë të mos përdoret për 2 veprimtari. Faleminderit.

**-Pjerin Ndreu:** Tani mos ta ngatërrojmë këtë punë. E para e punës ne nuk mund të mësojmë njerëzit se ku do e mbajnë të vdekurin, a në shtëpi, a në lokal dasmash, apo diku tjetër, kjo është çështje që e zgjidhin njerëzit vetë. Problemi është që aty ku zhvillohet ceremonia të mos ketë efekte negative për fëmijët, për popullatën tjetër afër, se mund të jetë një zonë e izoluar, një lokal

i izoluar kur njerëzit shkojnë pijë kafe dhe nuk ka efekte, ose në oborr të një shtëpie. Në zonat e ngarkuara urbane, ku popullata është e madhe, ku ka institucione të tjera të tipit shkollë, çerdhe, kopshte, popullatë të ndryshme që aksesojnë gjatë ditës qytetin, nuk lejohet dhe është kaq e qartë. Tani me i hy pjesës se pse bëre dasmë në dreqë e bëre mort në darkë mua më duket pak si shumë. Ti ke hall me t'i pru te biznesi jot, por nuk është detyra jonë si këshill me e bë atë gjë.

**-Erdhi këshilltarja Elsa Gazulli.**

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, projekt-vendim "Për miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë (Faza e Dytë)". Fjalën e ka kryetari i komisionit.

**-Agostin Marku:** Faleminderit. Kjo u diskutua në komisionin e financës, por edhe në komisione të tjera, pasi u bë një mbledhje e përbashkët e katër komisioneve, si asnjëherë tjetër edhe me pjesëmarrjen tuaj, Frida. Komisionet ranë dakord paraprakisht për gjithë procedurën e ndjekur për këtë fazë të dytë. Shifrat janë të njëjtat me ato të fazës së parë që është bërë dhe konsultimi publik. Në fazën e tretë që do bëhet së shpejti, që është e treta dhe e fundit, do bëhet një kalkulim më i mirë i gjithë shifrave dhe strategjive që do të jenë për gjithë periudhën dhe komisionet ju ftojnë si këshill që ta miratojmë pa asnjë lloj ndryshimi, por ashtu siç është paraqitur nga Bashkia Lezhë. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Kush e do fjalën? Po, zonja Marku.

**-Alfrida Marku:** Faleminderit. Për të saktësuar atë që nisi Agostini me sqaru, në fakt sa i përket programit buxhetor për vitin e ardhshëm edhe për dy vitet më pas, ne gjithmonë mundohemi që ta vëmë theksin tek rëndësia e madhe që kanë konsultimet publike. Në këtë logjikë, unë mendoj që bashkia duhet t'i kushtojë rëndësi edhe propozimeve që vijnë nga këshilltarë apo grupe këshilltarësh sa i përket adresimit të problematikave të ndryshme që kanë qytetarët me objektivin për t'i përfshirë këto në programin buxhetor të vitit apo afatmesëm. Pse e them këtë? Jo pa shkak, sepse në fillim të këtij viti kam paraqitur një listë problematikash drejtuar Bashkisë Lezhë duke argumentuar mbi rëndësinë e përfshirjes së këtyre problematikave apo disa prej tyre në programin buxhetor me qëllim për zgjidhjen e tyre. Probleme të tilla si nga çerdhet te bibliotekat, te rikualifikimi i lagjeve kryesore të qytetit, tek vëmendja më e madhe për moshën e tretë në njësitë administrative, tek vënia e theksit te erozioni, pavarësisht se kjo kërkon një angazhim financiar, jo vetëm të Bashkisë Lezhë, por dihet që erozioni në zonën e Kunes dhe të Vainit është problem tashmë. Tek një tjetër çështje që është mbjellja e pemëve, sidomos në qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin, bibliotekat në njësitë administrative që e thashë më lart, ndërtimi i një tregu të ri industrial në qytetin e Lezhës apo i tregjeve lëvizëse, kryesisht në zonën e Zadrimes, pra janë disa ndër problemet të cilat unë i kam adresuar me shkresë zyrtare drejtuar Bashkisë së Lezhës. Edhe unë mendoj që ashtu sikurse një ndër pikat e rendit të ditës sot është edhe raportimi nga ana e subjektit që ka menaxhuar plazhet publike, unë mendoj që përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë apo strukturat përkatëse në momentin që paraqesin një projekt të programit buxhetor për ta diskutuar dhe miratuar në këshill, duhet t'i shtojnë kësaj pike edhe argumentin e tillë: kemi pasur propozime ndër të cilat disa i kemi parë të arsyeshme për t'i përfshirë dhe i kemi miratuar, ose e

thënë shkurt, nuk janë miratuar dhe kjo është arsyeja pse këto projekte ne nuk i konsiderojmë prioritare në afatin një vjeçar apo tre vjeçar afatmesëm. Këtë e kam diskutuar edhe në komision dje, këtë unë gjej rastin për ta parashtruar edhe në Këshillin Bashkiak. Nëse ne nuk i kthejmë përgjigje propozimeve të këshilltarëve, atëherë me të njëjtën logjikë, unë mendoj se nënvlerësojmë edhe dëgjuesat publike që zhvillojmë me komunitetin. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Fjalën e ka kryetari i komisionit.

**-Agostin Marku:** E ndjej të nevojshme të sqaroj diçka rreth kësaj çështje. Shiko, çdo këshilltar, çdo qytetar ka të drejtën ligjore që të bëjë propozime, të bëjë sugjerime, por kjo s'do të thotë se të gjitha propozimet dhe sugjerimet të merren në konsideratë, apo edhe mund të mos merren asnjë në konsideratë. Është një politikë, është një strategji e bashkisë, pse jo edhe e këshillit edhe mazhorancave që janë në këshill, që vendos për gjëra të tilla, gjithnjë në përputhje me interesat e qytetarëve. Tani, të gjitha problemet që ngritët ju, zonja këshilltare, qëndrojnë si probleme, por kjo s'do të thotë se ka ndonjë kundërshti apo ka ndonjë moszbatim të rregullave për sa i përket çështjes së vendimarrjes për buxhetin. Është çështje tjetër pastaj në relacion, që relacioni mund të jetë më i shtjelluar, mund të thuhet që ngritën problemet qytetarët apo këshilltarët, u morën apo s'u morën në konsideratë. Nga ana ligjore, projekt-vendimi është shumë në rregull, është në përputhje me ligjin, është sqaruar gjithçka nga faza e parë në fazën e dytë, edhe me premtimin që në fazën e tretë do të jetë më i kalkuluar, sepse është faza përfundimtare dhe i shërben edhe vitit të ardhshëm, por edhe dy viteve të tjera. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Fjalën e ka kryetari i bashkisë.

**-Pjerin Ndreu:** Unë i kërkoj zonjës dhe kujdo këshilltari, që të heqë dorë nga populizmi dhe nga rreshtimi i gjërave gjej edhe thuaj. Në qoftë se i marrim një nga një ashtu siç tha Agostini, dakord qëndrojnë. Problemi është te mundësitë, një buxhet, dy buxhete, tre buxhete. Ne jemi këtu për të adresuar dhe çdo vit ne po adresojmë problematikë. Një problematikë që e kemi sot, që është një ndër problematikat më të mëdha, janë rrugët rurale. Situata e rrugëve rurale, me gjithë çfarë kemi mundur të bëjmë, ngelet prapë në nivele të mjerueshme. E dyta, ne me bibliotekën kemi ndërhyrë, me Pallatin e Kulturës kemi ndërhyrë. Bibliotekën tani ne nuk mund ta realizojmë ta çojmë në çdo njësi administrative se është absurde ta mendojmë sot në këtë fazë kur ne kemi gjëra bazike pa adresuar, kanalet e ujërave të zeza, kanalet e ujrave të bardha, ka filluar projekti, tani isha në lagjen e Spitalit, do vazhdojë poshtë tani komplet qyteti, lagjja Nënë Tereza po bëhet me ujë. Rrugët i kemi planizuar të gjitha, Shëngjini u bë me ujë, me sistem 20 Kv, energjia elektrike po stabilizohet. Janë dhe tre projekte të tjera që do vijnë, pra ne po ndërmjetësojmë, Milot-Balldreni po hapet, shumë gjëra po bëhen. S'po i them të gjitha tani. Ne do dalim me buxhetin e ri, do dalim me një sistem të organizuar qeveri-bashki me pothuajse 80% të sistemit të rrugëve rurale që duhet t'i ezaurojmë, duhet t'i mbyllim. Kemi llogaritur edhe çerdhen te shkolla Kosova. Do bëjmë projektin, po bëjmë shkollën Gjergj Fishta. Kopshti i lagjes Skënderbeg është në proces. Kemi 39 kopshte që ne në njësitë administrative po i rikuperojmë. Pra unë nuk mendoj se duhet të gjejmë patjetër diçka. Ajo puna e pemëve pa u adresuar këtu ku qyteti është

rrëmuje njëherë ku do të rikualifikohet, kam ngritur një ekip arkitektësh që të merret me problemin e lulishteve, rikualifikimit të komplet të lulishteve pas shtrimit të rrugëve që qyteti duhet të marrë komplet tjetër fokus dhe pastaj do të përcaktojmë ku ne duhet të mbjellim pemë, ku do të mbjellim lule, pra ka disa projekte, do bëhet pedonalja, do bëhet fusha poshtë nga stationi i trenit te Casa Ola, plus që do bëhet pedonalja dhe vendparkimi. Janë gjithë ato projekte që ne po realizojmë por është e pamundur që ne most ë lëmë ndonjë gjë pa bërë. Hiqni dorë nga këto dhe fokusohuni te ato gjëra që po bëjmë. Rrugët në qytet do bëhen në lagjen e Spialit, në lagjen Nënë Tereza, te tregu, te Gurrat, gjithçka dizenjohe ndryshe dhe qyteti vjen në konturet e një qyteti pasi ka eliminuar ujin dhe ujrat e zeza. Pastaj do fillojmë nga Bërzanae deri në Krajën me rrugët, këtu në këshill do vijmë.

**-Ndue Luli:** Fjalën e ka zoti Ndreca.

**-Erin Ndreca:** Dua të shpreh mendimin tim. Dikur kur bëja mësimet, filloja nga titulli i mësimit. Këtu thuhet: për miratin e PBA-së, faza e dytë. Nuk dua të ul kompetencat tona si këshilltarë zonja Frida, dua të them diçka tjetër, e kam thënë dhe e përsëris, prandaj quhemi këshill, patjetër të japim mendime, por vendimi është kolegjal. Nuk e përjashton njeri se duan të përjashtojnë, por mendoj që ka prioritete ku, siç e kam shprehur bashkia ka disa drejtori ku drejtohen çdo ditë problematika nga më të ndryshmet. Këto drejtori përbëhen nga specialistë, këto specialistë ndërtojnë një strukturë mbi të cilën ngrihet dhe planifikohet ky projekt buxhet. Tani unë personalisht mendoj që është shumë e rëndësishme të gjejmë ashtu siç tha kryetari, rrugët rurale të cilat janë një plagë shumë e madhe sesa këto pemët apo ato tregjet që ti përmende, të cilat nuk i mohoj që janë të rëndësishme, por sipas prioriteteve, sepse mendoj që është shumë e rëndësishme një rrugë. Një rrugë në fshatin Rrajcë, që gjej rastin që isha bashkë me kryetarin dhe në emër të njësisë atje e falenderoj pa masë për atë rrugë sepse me të vërtetë kur e pashë, kishte bërë një rrugë që, më fal, duhet të citoj një shprehje, aty ka dalë shprehja që i vdekuri mbyt të gjallin dhe atje u realizua një rrugë ku mund të shkohet me makinë në mënyrën më të mirë të mundshme. Prandaj nuk mendoj që këtu kemi ardhur që unë dhashë këtë mendim dhe pse s'u mor ky mendimi im, nuk më duket logjike dhe nëse do i shtrojmë gjërat në këtë formë. Jo nuk ka rëndësi ta mora si shembull që është realizuar një rrugë, një rrugë rurale mendoj se është shumë më e rëndësishme se ajo që thua ti, dhe mësoju të kesh një çik respekt, sepse kur flet ti të dëgjoj me shumë vëmendje dhe mos ta nisim gjithmonë në këtë formë që unë thashë kështu ju se morët dhe thjesht kapim mikrofonin dhe të themi diçka. Sa herë kemi dëgjuar që s'do bëhen shumë gjëra të cilat në fund janë realizuar dhe ato që thua ti, padyshim që do realizohen, por kanë kohën e tyre, nuk realizohen të gjitha njëherësh siç thua ti, prandaj mendoj që duhet të vazhdojmë, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Mendim tjetër? Zonja Ndoj ka fjalën.

**-Donika Ndoj:** Përshëndetje të gjithëve. Në fakt ky projekt vendim për 2026-2028 na vjen mirë që është një projekt buxhet në rritje. Nga njëra anë vërejmë rritje të buxhetit, por duke parë këto zërat e shpenzimeve, vëmë re se te disa sektorë kyç, shpenzimet vijnë duke u ulur. Përpos

infrastrukturës, normal që ka rritje të shpenzimeve, ajo çfarë vëmë re në turizëm, kulturë, arsimi, përkujdesje sociale, në të cilat shpenzimet vijnë duke u ulur. Në fakt për këtë desha të diskutoja pak, sepse këto janë sektorë shumë të rëndësishëm të jetës shoqërore edhe për qytetarët. Normal se këtu i takon që disa shërbime vijnë duke u reduktuar. Kështu që unë nuk e kuptoj cilat janë shërbimet që vijnë duke u reduktuar. Është e vërtetë që nuk mbyllen të gjitha ato që themi ne mangësi në të gjitha këto sektorët, por kryetar ka mangësi edhe në arsim, por ka mangësi edhe në turizëm e në gjitha këto, sepse ndodh që në shkollë nuk kemi një bazë materiale më minimale ndoshta letër apo printer, pavarësisht kompetencat e kujt janë se ne mundohemi të ndajmë edhe kompetencat apo edhe ndoshta dhe kopshtet që u fol njëherë që do të shtroheshin me parket e të tjerë, njëherë u mendua të shtroheshin, pastaj filluan edhe nuk e di se kur..., të gjitha këto janë diskutuar, janë thënë, por ne shohim që dhe buxheti vjen duke u zvogëluar, shpenzimet në këta sektorë vijnë duke u zvogëlu. Unë mendova që ta diskutoj këtë dhe konkretisht mendoj që të rishikohet si projekt vendim për këto zëra, pasi janë shtylla shumë të forta, arsimi, cilësia në arsim, kultura, promovimi i kulturës. Madje dje u mbajt edhe dita e trashëgimisë kulturore, ditë mjaft e rëndësishme për ta promovuar, sepse Lezha ka një trashëgimi jashtëzakonisht shumë të pasur kulturore, etnografike e të tjera. Janë bërë organizime në të gjitha shkollat, ndoshta ka pasur dhe nga ata prindër që ka thënë, unë do t'ia marr atë kostumin popullor që të shkojë të përfaqësojë? Kështu është ekonomia, kështu që në qoftë se nuk ka investime në kulturë fillojnë edhe të zbehen të tkurren, unë s'po them një kostum për një ditë, por ndodhin edhe këto shqetësime që do të bëhet një eveniment këtu në bashki, por që mirë është që të ketë edhe organizime, kështu që shpresoj që okej, le të rindahen këto shërbime, por disa shërbime janë reduktuar në këta sektorë kyç, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Fjalën e ka kryetari,

**-Pjerin Ndreu:** Dakord jam unë, duhet të keni parasysh një gjë, që e para sivjet jemi në një investim në 39 kopshte. Do të sugjeroj e nderuar këshilltare që të shkosh një vizitë te kopshti i Zejmenit dhe të shohësh se është shtuar me parket, edhe me kondicionim brenda, atëherë në qoftë se s'është bërë janë në proces të gjitha, nënkryetarja thotë është bërë, ti thua se s'është bërë. Kështu që zgjidheni ju të dyja. Kush po e ndjek këtë punë, Keler a di gjë ti çfarë bëhet?

**-Keler Sufja:** Ato të gjitha kanë pasur planin e vet, disa janë bërë gati, disa po bëhen, pra është një proces që vijon, nuk janë për një ditë, por patjetër që janë me kondicionim, me parket, me dyer, me dritare.

**-Pjerin Ndreu:** Në rregull, e para në qoftë se s'është bërë akoma, është në proces për t'u bërë, se janë në proces, pra është prokuruar, i ka marrë firma në dorë dhe janë duke u bërë, duke qenë se bëhen 39 të tilla, normalisht që ne s'mund të bëjmë 39 në vit, është absurde ta mendosh, e dyta hyn edhe programi i qeverisë në këtë mes, nuk hyjmë vetëm ne, sot që flasim, ne po bëjmë një shkollë, edhe në arsim fokusohet ajo, sot që flasim kemi aplikuar edhe një tjetër, vitin tjetër sivjet, me këtë qeveri, vitin tjetër kemi planizuar çerdhen, kemi planizuar kopshtin në lagjen Skënderbeg, do planizojmë me qeverinë me bë edhe riparimet e shkollave të tjera, pra mos harro

se programi i arsimit shkon në harmoni edhe me programin e qeverisë që ne marrim projekte atje, domethënë financohemi dhe nga qeveria dhe duke futur edhe qeverinë me shkollën Gjergj Fishta edhe me tjetrën që do marrim besoj dhe kemi shumë shpresë që ta marrim. Besoj se në vlerë, nuk biem po ngjitemi, pra mos ta shikojmë gjithmonë se jo çdo gjë e adreson buxheti i bashkisë, e dyta, me të thënë të drejtën për kulturën, unë nuk mendoj se jemi ekselent, normalisht, po që jemi më të mirët, unë ndjek edhe faqet, por ne kemi cilësinë e aktiviteteve, e lirshmërinë, mundësinë që i kemi dhënë kujdo, e nuk kemi lënë një festë pa adresuar, e nuk kemi bërë një, në qoftë se ka qenë dita e trashëgimisë kemi bërë dy aktivitete, jo një. E para ka qenë hartografimi që duhet të ishte të gjithë, fotografimi dhe dokumentimi i gjithë zonave me potencial arkeologjik në Lezhë që ka bërë një grup arkeologësh me në krye Neritan Cekën që s'ka më të mirë në Shqipëri se ai. Pastaj gjithë shkollat kanë demonstruar aty gjithçka kemi ne si vlerë dhe e dini si ka qenë Pallati i Kulturës se si është bërë tashi, nuk kemi ardhur këtu me bë bilanc, kemi ardhur me thënë që ne e kemi rigjallëruar, kemi lënë çdo grup artistik që ta dish, që le të jetë privat, punë e madhe, njëri ka kërcimin, tjetri ka çiftelia, tjetri ka një grup këngësh, djemtë e detit, e kanë pa lekë Pallatin e Kulturës në një orar kur ata duan, pra Pallati i Kulturës është një derë e hapur për gjithkënd që ka me përgatit një gjë artistike, kushdo qoftë ai, s'ka rëndësi se s'pagan asnjë lek, çdo i ri ose re e shkollës apo kushdo që ka ardhë, nga Lezha, të rinj që kanë bërë teatër, e kanë marrë me zero lek Pallatin e Kulturës, QKF-në, me zero ua kemi lënë ne, tashti a ka akoma për të bërë, sigurisht që ka se ne nuk jemi ekselent, por mund të them që janë dhënë inpute të forta, ju kërkoi dhe juve ndihmë, na jepni ide, çfarë feste mund të krijojë Zejmeni, se u kam thënë këtyre të kulturës, ore më thoni zonë për zonë, njësi për njësi, shpikni një festë atje, edhe e vëmë në buxhet, ore ne Zejmeni kemi një festë që e festojmë gjithë zona dhe ne mund të organizojmë një gjë ose e bën Zadrime ose e ka Pllana, ose e ka Malësia, çfarë rëndësie ka se kush e ka, pra ne jemi të gatshëm me hy në lojë me buxhet nëse na jepet një ide dhe do mundohemi në buxhet sivjet ne të fusim një sistem prapë rilodi ku i lëmë me konkuru grupet artistike të ndryshme, prodhime të ndryshme artistike me projekt ku këshilli artistik i përzgjedh të gjithë projektet e duhura artistike që mund të përfitojnë. Se çfarë ndodh, vijnë në mes të vitit sivjet na duhen 3 milionë lekë, na duhen 2 milionë lekë të vjetra për me bë një gjë, ne nuk i kemi lekët e buxhetit të bashkisë fut dorë në xhep edhe nxirri, njerëzit jashtë kujtojnë se i kam unë po unë s'kam gjë. Vij këtu, jo po pse e ndërrova këtë, pse e bëra këtë, detyrohem me sponsor, ka gjithë ato shfaqje që jepen në Pallatin e Kulturës dhe ne ua kemi hapur krahun, edhe me sponsor, edhe një shfaqje tjetër edhe një që u dha, edhe të tjera ne maksimumin po mundohemi me bë, por ka prapë, atëherë futeni në lojë, ta energjizojmë jetën edhe nëpër njësi, s'jam kundra. Për shembull, ne patëm rastin e Zadrimes që bëmë, s'e vazhduan, ajo ishte super, një dasmë zadrimore që kishin bërë herë të tjera por që ka sharm, domethënë ata njerëz që erdhën aty erdhën për të marrë pjesë në një ritual të vjetër që ishte fantastic, s'kemi asnjë pengesë ne, fare.

**-Ndue Luli:** Faleminderit dua të sqaroj diçka para se ta hedhim në votë. Ky projekt vendim është për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2026-28 dhe ne flasim se çfarë është bërë. Është

projekt vendim për të ardhmen, ju lutem shumë, i bëj thirrje të gjithë këshilltarëve që ta shikojmë mirë projektvendimin para se të flasim për të dhe të flasim direkt për pikën që kërkon ai.

Atëherë për projektvendimin që thamë kush është dakord? Miratohet me 26 vota Pro. Këshilltari Kristin Gjiodaj votoi Kundër. Këshilltarët Emanuel Përkaku, Donika Ndoj, Donika Haxhia, Alfrida Marku, Gjon Marku votuan Abstenim, 5 vota Abstenim.

Kalojmë te pika 5, projekt vendim “Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e dytë të vitit 2025”. Fjalën e ka kryetari i komisionit,

**-Agostin Marku:** Edhe ky projekt vendim u diskutua në katër komisionet që zhvilluan mbledhjen e përbashkët, jemi dakord ta kalojmë, është një çështje që diskutohet herë pas here me informacionet që depoziton drejtorja e financës në Këshillin e Bashkisë, konform ligjit dhe ju ftoj të gjithë këshilltarëve ta miratojmë, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Mirë, kush ka pyetje, diskutime, s'ka, atëherë kush është dakord me projekt vendimin? Miratohet me 25 vota Pro. Këshilltarët Emanuel Përkaku, Donika Ndoj, Donika Haxhia, Alfrida Marku, Rrok Marku, Gjon Marku, Kristian Gjiodaj votuan Abstenim, 7 vota Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë tek pika 6, projekt vendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025””. Edhe për këtë projektvendim fjalën e ka kryetari i komisionit të financës.

**-Agostin Marku:** Unë para du me thënë diçka, të drejtën e votës e ka gjithsecili, por se pse abstenohet dhe votohet kundra në buxhetin faktik, unë vetëm në Këshill të Bashkisë së Lezhës e vë re, faleminderit.

Tani për sa i përket projekt vendimit tjetër, ky projekt vendimi i radhës është një projekt vendim që unë rrallëherë e kam parë në këshillat bashkiakë, është një projekt vendim që ka të bëjë me rritjen e të ardhurave, është një projekt vendim që ka të bëjë me përgjegjësinë e bashkisë për të menaxhuar mirë të ardhurat, për të marrë edhe të gjithë ato detyrime që kanë subjekte apo ente shtetërore ndaj Bashkisë së Lezhës, dhe kemi një projekt vendim, kemi një ndryshim në buxhetin e bashkisë që ka të bëjë me rritjen e të ardhurave dhe adresimin e këtyre të ardhurave në shpenzime, në shërbime më të nevojshme, më urgjente që kërkohen në Bashkinë e Lezhës, çka flet për një seriozitet dhe menaxhim të shkëlqyer të çështjes së të ardhurave, ndaj ju ftoj të gjithëve ta miratojmë, pasi dhe komisioni ishte pro miratimit, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit, në lidhje me këtë projekt vendim, kush ka ndonjë pyetje, diskutim, nuk ka. Kush është dakord me projekt vendimin? Miratohet me 28 vota Pro. Këshilltari Kristian Gjiodaj votoi Kundër. Këshilltarët Emanuel Përkaku, Donika Ndoj, Donika Haxhia votuan Abstenim, 3 vota Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë tek pika 7, projekt vendim “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 103, datë 19.12.2024” Për miratimin e bursave të nxënësve të klasave të X-ta të arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2024-2025”

Janë dy projekt vendime që bëjnë fjalë për shkollën “Kolin Gjoka”, një sqarim të shkurtër mund të na japë kryetari i komisionit, por edhe anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë dje, shkurtimisht, sepse në komision me ç`di unë, dje është dalë tamam me mendimin e duhur.

Fjalën për këtë e ka zonja Haxhia.

**-Donika Haxhia:** Faleminderit, atëherë për të sqaruar të interesuarit. Këto dy projekt vendime dhe unë mendoj të kalojnë bashkë, nuk kemi pse marrim njëherë njërin, njëherë tjetrin, sepse i pari është për klasat e 10-ta për arsye se ku e marrin ata bursën, në ç' vend e marrin dhe i dyti për klasat e ndërmjetme, por bëhet fjalë për të njëjtin problem dhe për të njëjtën shkollë dhe prandaj thashë edhe që të mos hamë kohë kot, mund t'i kalojmë që të dyja bashkë, edhe pse dje nuk është se ishin të gjithë anëtarët e komisionit, por e diskutuam.

**-Ndue Luli:** S'ka problem, mund të diskutoni tani dhe pastaj i ngremë njërin pas tjetrit.

**-Donika Haxhia:** Për të gjithë të interesuarit bëhet fjalë për disa ndryshime në vendimin e marrë në lidhje me akordimin e bursave të nxënësve. Vjet u mor një vendim, po në fakt unë e thashë edhe vjet, po duhet të jenë shumë të kujdesshëm ata që i paraqesin këto projekt vendime, sepse janë ata që kanë përpara edhe ligjin, kanë përpara edhe dosjet e nxënësve që ne si këshilltarë nuk i kemi, pra unë nuk mund ta di çfarë kriteresh plotëson çdo nxënës dhe unë në mirëbesim tek ata që i sjellin këtu normalisht që do t'i besoj dhe të gjitha këto janë të verifikuara realisht dhe unë propozoj që të kalohen sepse ne si shkollë na kanë hapur një problem shumë të madh sivjet me takimet me prindërit, tre nxënës na janë larguar me idenë që ju nuk na jepni bursa domethënë ishte gënjeshtër ikën në Laç edhe në Fushkrujë, me gjithë përpjekjet tona të vazhdueshme edhe me ministrinë si shkollë. Një problem tjetër që kisha unë për konviktin.

**-Ndue Luli:** E lëmë te pika “Të ndryshme” të lutem.

**-Donika Haxhia:** Jo, jo, jo, më fal, sepse nxënësit që nuk janë pranuar në konvikt, nuk kanë të drejtë të marrin bursë, për një arsye apo për një tjetër, tani unë nuk dua të paragjykoj kërkënd, duket pak banale, po duke qenë mësuese më duhet të sjell edhe disa opinione të nxënësve, nxënës që janë larguar dhe thonë që konvikti nuk funksionon të shtunë-të diel, tani ata mbase ikin vetë në shtëpi dhe nuk ka si të hanë në konvikt dhe unë nuk di si funksionon pastaj për ditët e pushimit, por për një rast konkret që një vajzë është larguar në Vlorë se nuk kishte ku të rrinte më se i ikën familjarët, ka marrë përgjigjen që konvikti nuk punon në fundjavë. Më duhet ta adresoj. Unë e kam me mesazh këtë nga nxënësja. Dikush i ka thënë këtë përgjigje, tani unë thashë do duket banale sepse është opinion nxënësish.

**-Ndue Luli:** Unë mendoj që duhet ta kishe zgjidh me autoritetet përpara se me e thënë në këshill, kur e thua në këshill do të thotë se është një fenomen, nëse është një fenomen, kjo është

shqetësim, po nëse kjo punë është punë sms-sh e pavërtetuar, e patrajtuar atëherë nuk është muhabet këshilli ky.

Keler si është puna?

**-Keler Sufja:** Nëse më lejohet të trajtoj të dyja problematikat që u ngritën.

Sa i takon bursave, në fakt me këtë rast unë gjej rastin që edhe po themi me aq sa kemi mundësi ne ta adresojmë këtë gjë, ta zgjidhim njëherë e mirë, edhe më herët kur është marrë fillimisht si vendim, drejtorja e arsimit e ka sjellë kërkesën në bazë të kriterëve të VKM-së, atëherë këshilli nuk e di për çfarë arsye ka tejkalu po themi këtë, nuk e di, kompetencën e gjykoni ju pastaj, po ka kaluar po themi kriteret e VKM-së, për pasojë atje në ministri ky buxhet është bllokuar dhe ne jemi detyruar që të ribëjmë kërkesën. Po të doni ne dhe e gjejmë se kërkesa është zyrtare, kështu që është aty, vërtetohet se si kanë qenë kriteret që ka parashikuar drejtorja e arsimit për bursat. Sa i takon konviktit, konvikti është hapur shtatë ditë të javës, është nonstop hapur, patjetër ka po themi edhe roje që janë gjatë gjithë kohës aty, ka dhe kujdestarë që alternohen në bazë të orareve, kështu që në asnjë rast, në asnjë moment, për asnjë arsye apo në asnjë rast nuk jemi ne në dijeni që të ketë një rast që dikush të largohet, që është një masë e ashpër, mua do më vinte keq nëse do kishte ndodhur si gjë, po në rastin më të thjeshtë, të paktën ne do ishim vu në dijeni si drejtori edhe patjetër ne do e kishim adresuar gjënë, nuk di të ketë një rast, pra përpara se ne të shkojmë tek nuk paraqitem në shkollë apo nuk shkoj apo nuk futem te kjo shkollë se nuk jam në konvikt, unë besoj që të paktën një kërkesë sepse ne na vijnë edhe ankesa shumë më minimale në drejtori edhe i marrim të gjitha shumë seriozisht e më vjen sinqerisht keq, pra, nëse do ishim para këtij fakti, ne do e kishim adresuar, sepse konvikti është i hapur, konvikti është gjatë gjithë kohës, se çfarë ndodh, nuk bën sens, sepse konvikti nuk funksionon si institucione shtetërore me tetë orë vetëm nga e hëna deri të premten, se nuk bën sens, në qoftë se e bëjmë kështu dhe s'kemi bërë asnjë gjë, atëherë ne s'kemi hapur një konvikt, ne kemi hapur një institucion të përkohshëm, ai nuk është qendër ditore, është konvikt, pra nuk bën sens.

**(Ndërhyn zonja Haxhia)**

**-Ndue Luli:** Një gjë dua të them dhe ta kenë parasysh të gjithë këshilltarët dhe të gjithë pjesëmarrësit. Mos të flasin me hamëndësime. Nxënësit i duam shumë, i respektojmë shume dhe pa ta nuk kanë çfarë bëjnë as mësuesit e as prindërit, por përderisa ka drejtori shkolle, ka dhe drejtori konvikt, ka kujdestar konvikt, shkohet e pyeten ata, nuk është nevoja që të marrim mendimet e nxënësve e t'i sjellim këtu.

Fjalën e ka zoti Agostin.

**-Agostin Marku:** Dje në mbledhje të komisionit janë qartësu këto probleme. Me dashtë me ba shoë, hajde bëjmë sa të doni. E para, çështja e kriterëve, nuk ka asnjë faj Bashkia e Lezhës. Është këshilli, unë i pari, poredhe ju, jemi nisë me mendimin e mirë sepse ishin normat, kishte bursa dhe thamë t'i japim të gjitha që t'i plotësojmë njerëzit në maksimum nga detyrimet që ka këshilli për t'i shërbyer qytetarëve dhe në rastin konkret nxënësve që ishin drejtuar pranë bashkisë për

bursa. Në qoftë se kemi bërë debat me bashkinë, jo vetëm për këtë rast, por edhe për raste të tjera, ne kemi bërë debat me bashkinë që ç'keni ju, kur duam të marrim vendim ne, pra mos ta përziejmë bashkinë në këtë çështje, por edhe këshilli është nisë me qëllimin e mirë, jo me qëllimin e keq. Ka dalë në kundërshtim sepse janë fonde financiare edhe ka dalë me kriteret, e kanë kthyer, hajde ta rregullojmë dhe nuk ka të bëjë as me prishje imazhi, as me atë që po na ikin nxënësit nga shkolla "Kolin Gjoka", as gjëra të tjera, mos t'i japim këtë linjë. Sa i përket konviktit, nuk mund të ndodhë kund në botë që të ketë konvikt e të jetë me orare të kufizuara, kjo është kot. A funksionon mirë, a nuk funksionon mirë, a ka çështje cilësie të ushqimi, a ka çështje pastërtie, këto janë çështje të tjera, por edhe sikur të ketë ndonjë rast kufizimi, shkolla "Kolin Gjoka" me konviktin, dhe më vjen shumë keq se shkolla "Kolin Gjoka" është edhe në linjën e ministrisë time dhe të bashkëpunimit me drejtorinë që unë drejtoj dhe është shumë përgjegjëse edhe për këto probleme, e kanë as 50 m dhe nuk e ka ndaluar kurkush shkollën "Kolin Gjoka", kur ngre një shqetësim nxënësi për të shkuar për ta verifiku aty dhe e sqaruam edhe dje, e sqaruam edhe me drejtorinë përkatëse e me të gjitha dhe një diçka që sqarohet në komision, nuk është mirë ta bëjmë këtu. Hajde bëjmë deklarata, edhe unë bëj deklarata politike edhe çdo këshilltar ka të drejtë me bë deklarata politike ashtu sikur i gjykon, ama të thuash se ka thënë nxënësi se nuk funksionon konvikti dhe mua më duket se s'funksionon konvikti, kjo është jashtë logjike. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro.

Kalojmë te pika 8, Projekt-Vendim "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 104, datë 19.12.2024 "Për rishqyrtimin dhe miratimin e bursave të nxënësve të viteve të ndërmjetme, të shkollës së mesme profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë, për vitin shkollor 2024-2025".

Është e njëjta gjë vetëm se projekt vendim tjetër.

Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro.

Faleminderit.

Kalojmë te pika 9, Projekt vendim "Për miratimin e akordimit të fondit për shpërblimin e sportistit kampion kombëtar", keni relacionin aty, fjalën e ka kryetari i komisionit.

**-Agostin Marku:** Shumë dakord është komisioni, për ta kaluar vetëm me një sugjerim, që raste të tilla të na sjellë sa më shumë bashkia që të stimulojmë rekordet edhe të nxisim pse jo edhe të tjerë që në profesione apo në edhe në aktivitete sportive të arrijnë rekorde nga Bashkia e Lezhës, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Fjalën e ka zoti Përbjaku.

**-Emanuel Përbjaku:** Përsëritje të gjithëve. Ky është një vendim që i motivon sportistat e qytetit të Lezhës po kam një pyetje se te ky rast jam pak a shumë i informuar dhe aty në faqe të

Bashkisë Lezhë është postuar që dy kampionë të mundjes, janë kampionë kombëtarë por nga projektvendimi që kemi shohim që veç njëri ka marrë shpërblim. Si është bërë përzgjedhja?

**-Ndue Luli:** Fjala për kryetarin.

**-Pjerin Ndreu:** Ne disponohemi për të gjithë trajnerët e shumësporteve, të shumë disiplinave, me pagesë dhe me sportistët kampionë, tani këto i përzgjedh një shoqatë e cila merret me këtë punë, jo ne si bashki. Ne na vjen propozimi filani ka dalë kampion kombëtar dhe sipas asaj që kemi miratuar vetë, japim shpërblimin përkatës, nëse shoqata na e sjell, ne themi po, ne s'kemi çfarë përzgjedhim, nuk jemi ne ata që e përzgjedhim, ne hyjmë në rolin e sponsorit, mbështetësit të sportit, ne nuk jemi pjesë e komisionit, e shoqatave, pra me ligjet e reja nuk jemi ne pronarët e ekipeve, as të shoqatës, as të futbollit, ne hyjmë në rolin e mbështetësit të sporteve, pra kuptojeni rolin e bashkisë si këshilltarë, nuk jemi ne pronarë, ne në kuadrin e energjizimit të jetës së përditshme të këtij vendi ne nxjerrim ca lekë që t'i stimulojmë, ja këtë që po bëjmë.

**-Alfrida Marku:** Në fakt ku ta marrim që të kemi sa më shumë raste të tilla, të rinj të angazhuar në sport aq më tepër kampion, por unë kam vetëm një rezervë për shumën e shpërblimit, sikur të ishte kampion i bashkisë 100 mijë lekë edhe s'është e arsyeshme, por kampion kombëtar, unë mendoj që ta rishikojmë si shumë, të jetë diçka më dinjitoze se kaq. Faleminderit,

**-Pjerin Ndreu:** Ka të bëjë me buxhetin që i kemi akorduar ne shoqatës. Shoqata bën detajimin e buxhetit, ne i vëmë shumën në dispozicion dhe për mënyrën si e shpenzon, janë të detyruar të na sjellin bilancet financiare. Nëse ata duan më shumë lekë në buxhetin që vjen, sepse e justifikojnë arsyen pse, se janë edhe tre kampionë të tjerë, ne pastaj shtojmë buxhetin për shumësportet, pra edhe njëherë, është e lidhur me ata, me propozimin e tyre, me skemën që bëjnë ata, me shpenzimet e transportit që bëjmë ne për shumë gjëra të tjera.

**-Keler Sufja:** Për ta nisë aty ku e la kryetari dhe me shpresën që edhe e shterrojme si gjë, patjetër ne kemi kontrata dhe marrëveshje me klubin shumësporte, jo me sportistë individualë, në rastin kur kemi më shumë sesa një kampion, mund të jetë rasti që janë edhe kampionë të rinjtë. Ne kemi një kriter që ne mbulojmë me shpërblime ata që janë moshë madhore, patjetër edhe në gjykimin tim personal, kjo është një pikë që ne ndoshta dhe mund ta adresojmë në planet apo në buxhetin e vitit që vjen, që si masë pozitive për të mbajtur sidomos talentët e rinj që janë pa mbushur 18, që të mos largohen te klubet e tjera të rëndësishme sikurse është Tirana për shembull, është që ne këtu në vijim të shikojmë një mundësi që edhe të rinjtë që dalin kampion t'i stimulojmë me një buxhet në mënyrë që ne nga të rinjtë pastaj kur të kalojnë te mosha madhore të vazhdojnë të qëndrojnë me klubin shumësporte Besëlidhja. Patjetër a do ishte mundësia Alfrida t'i bënim pagesa më shumë, absolutisht që po, ama çfarë ndodh, sidomos po flasim në rastin konkret për disiplinën e mundjes, mundja vetëm vitin e kaluar ka parashikuar që do ketë më shumë sesa një kampion. Ne kemi parashikuar një buxhet që të shkojë diku te gjashtë deri në shtatë, prandaj edhe buxheti pastaj është ai që është, ama nuk ka rezultuar kështu, çfarë do bëjmë, ne jemi të detyruar pastaj që të rishikojmë buxhetet tona, por kampioni në fjalë përveç, kjo është vetëm shpërblim ë, kampioni në fjalë për çdo muaj merr dhe një pagesë tjetër që është

si tip page, roge apo po themi që e përdor për nevojat që nevojiten te sporti i tij. Unë nuk e di nëse më herët disiplina të ndryshme janë suportuar kaq shumë, me të thënë të drejtën, edhe pse e kam mjek edhe si dashamir, por patjetër që kena mundësi ta përmirësojmë edhe një nga ato elementë që thashë është edhe kjo, plani apo projekti jonë që edhe të rinjtë t'i përfshijmë në një pagesë të caktuar, siç ka ndodhur me mundjen në këtë rast, kështu ndodh me të gjitha rastet, gjithmonë kërkesat vijnë nga klubi shumësporte, jo nga sportistë individualist, ne nuk kemi marrëveshje me gjithsecilin, ne kemi marrëveshje me klubin e sportit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro, faleminderit.

Kalojmë te pika 10, projekt vendim "Për përdorimin e metodologjisë LOD për alokimin e fondeve për organizatat sportive të shoqërisë civile e miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 211, datë 31.10.2017"

Edhe për këtë fjalën e ka kryetari i komisionit.

**-Agostin Marku:** Po, është një projekt vendim që nxit të gjitha shoqatat e ndryshme që merren me aktivitete sportive në Bashkinë e Lezhës për të marrë pjesë në këtë thirrje që mbështetet nga Bashkia me financa duke shpallur fitues ato projekte që janë me efektivitet më të lartë, që ndikojnë direkt në cilësinë e aktiviteteve dhe në shumëllojshmërinë e aktiviteteve, është gjë pozitive dhe duhet t'i hapim rrugë këtij projekti, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Kush e do fjalën? Po, zoti Gjiododa.

**-Kristian Gjiododa:** Personalisht si projekt vendim e shikoj një iniciativë e mirë, por e shkuara realisht tregon ndryshe në vendimmarrjet e aparatit të bashkisë. Ne këtu flasim për projekte të tilla apo dhe për shpërblimin e mëparshëm, pavarësisht se kaloi si pikë, por dua t'i përmbledh nga që janë të dyja në aspektin e sportit, shpërblimi i moshës madhore, ky është një kriter diskriminues në aspektin sportiv, në qoftë se flasim për sport, nuk ka moshë madhore dhe moshë minorene, përkundrazi, minorenët apo fëmijët duhet të mbështeten më shumë se mosha madhore. Kërkesa apo vendimi bëhet për shpërblimin nga vetë shoqata, ore po në qoftë se vetë shoqata do na sjellë një,... s'di të them, që s'ka lidhje fare dhe do thojë ka dalë kampion, ky duhet me marrë shpërblim edhe kjo është një pikë që unë e shoh në rregullore shumë të çorganizuar apo mund të gjykoj që të jetë selective, kam të drejtën ta gjykoj për selektive. Miratimin e metodologjisë unë jam dakord sepse e kam lexuar me vëmendje metodologjinë e akordimit të fondeve apo përfituesve të projektit, por unë do t'ju them konkretisht se e shkuara e Bashkisë së Lezhës apo aparatit të Bashkisë, duke qenë se përfaqësoj dhe jam drejtuesi edhe i një institucioni që ka lidhje me sportin dhe kemi në aktor apo në juridiksionin tonë rreth 650 fëmijë që praktikojnë sportin më popullor në botë futbollin, që disa prej atyre fëmijëve janë edhe fëmijë të këshilltarëve këtu dhe po ju them që sot që do të plotësojmë të gjithë kriteret dhe do të aplikojmë te ai projekt i këtij projekt vendimi dhe do shikoj nga aparati i bashkisë se si dhe sa korrektësi do ketë. Unë nuk jam kundra as basketbollit, as futbollit, as Besëlidhjes, por jemi të gjithë këtu dhe hajde të

bëjmë një analizë, si do ishte më mire, të financojmë 650 fëmijë konkretisht që praktikojnë sportin më popullor në botë futbollin që janë të Lezhës apo të financojmë okej shumë mirë sportet profesioniste si futbollin apo basketbolli i Besëlidhjes. Secili prej jush, jam bindur që në vetvete mendoni që kjo është e drejta, por nganjëherë ndoshta duhet edhe me votu ndryshe ose mos me fol, pra unë nuk jam kundër projektvendimit, jam pro këtij projektvendimi, por dua t'i them aparatit të bashkisë që kur të jetë çështja për financime në sport, ne duhet të financojmë në embrion, ne duhet të financojmë aty ku vlen financimi, faleminderit kaq kisha.

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Fjala për kryetarin.

**-Pjerin Ndreu:** E para njëherë, asnjë lloj fantazie që nxjerr kush nga këtu se mund të ketë favorizim, shoqata e përralla të tilla mua s'më hyjnë fare në aparatin e bashkisë fare. Ne i kemi, ne i kontrollojmë të gjithë lekët që japim, plus që na kontrollon edhe kontrolli i shtetit kur vjen, pra ne kemi mekanizma kontrolli të imtësishëm, ne nuk mund të bëjmë çfarë të duam ne, dikur u bënte çfarë të donte me këshill dhe me kompani, sot nuk ka shans me u bë, as me ne që jemi këtu dhe nuk di ndonjë rast kur i kemi marrë paratë e bashkisë dhe i kemi bërë kështu tollovi. Unë di kaq, shumë sporte kanë marrë zero lekë, këtë e di dhe si ka pyet kush se janë gjallë, a kanë vdekur, ndërsa sot ne duam projekt, kush është projekti, në qoftë se ti vjen me konkuru pa projekt, një projekt që më tregon mua se unë jam këtu e dua të shkoj këtu dhe më duhet edhe ndihma e bashkisë, jo vetëm e bashkisë, se po të marrim basketbollin për shembull, që për basketbollin 60% të faturës e paguan biznesi, nuk e paguan bashkia që ta dini, është kampion mbrëmë mori superkupën, absolut është fare, ka fituar dhe me ekipet e Kosovës, është një projekt, një projekt i cili ka dhënë produkt, pra ne nuk kemi si mos ta mbështesim, kemi nisur një projekt me futbollin, është një projekt i cili është vënë në tavolinë, është diskutuar me bashkinë, ne do ta mbështesim, ama projekte ku merren lekët njerëzve për me lujt futboll, ne nuk mbështesim, dakort, kështu që projektet private kush i ka t'i bëjë, t'i zhvillojë, ne s'i kena ndalu dhe s'merremi fare, merr lekë atyre që përgatit, po shumë mirë bën, biznes është, sa ka ndaluar njeri, bëje.

**-Ndue Luli:** Tjetër? Fjalën e ka zoti Gjিদoda.

**-Kristian Gjিদoda:** Tashi ne mos të bëjmë këtu lojra fjalësh, jo marrin lekë, s'marrin lekë s'ka projekte, ka projekte. Unë konkretisht shoh edhe gjë më minimale, publikimi nga aparati bashkisë në rrjetet sociale edhe aty shoh selektivitet, ore kush e ndal, okej s'ka ba projekte shoqata rajonale e futbollit Lezhë ose klubet e futbollit të tjera përveç Besëlidhjes. Kush e ndal Bashkinë Lezhë të publikojë rezultate pozitive në futboll elitare, ashtu siç publikon basketbollin ose siç publikon futbollin tjetër, e ndal njeri?, pse s'e kanë ba?, pra mua më lind e drejta dhe kujtdo i lind e drejta dhe kushdo e kupton që deri sot ka pasur selektivitet ose deri sot s'ka pasur frymë bashkëpunimi ose deri sot nuk ka pasur dëshirë, pastaj do ta shohim në të ardhmen, t'ia lëmë kohës.

**-Ndue Luli:** Mirë faleminderit. Fjalën e ka zoti Marku.

**-Agostin Marku:** E gjithë kjo procedurë për miratimin e këtij projektvendimi vjen nga një vendim i këshillit të bashkisë dhe ky vendim i këshillit të bashkisë zoti Gjioda është i vitit 2017 kur kryetari i këshillit të bashkisë ka qenë zoti Gjioda, në qoftë se ai vendim në atë kohë është bërë i keq, hajde ta rregullojmë dhe në qoftë se ka të bëjmë me mungesë transparence, atëherë mungesa e transparencë paska filluar qysh në 2017-ën. Faleminderit,

**(Ndërhyn zoti Gjioda pa mikrofon dhe replikon me zotin Marku)**

**-Ndue Luli:** Fjalën e ka kryetari i bashkisë.

**-Pjerin Ndreu:** S'i marr për bazë fare se çfarë thotë njëri apo tjetri sepse janë gënjeshtër. Kushdo, qytetar jo vetëm organizata, në fushën e kulturës, artit apo në fushën e sportit që ka sjellë material, ne menjëherë e publikojmë te faqja e bashkisë, kushdo qoftë, s'kena bë asnjë lloj selektiviteti fare, politikisht kena plot kundër aty që i nxjerrim përditë, e ua nxjerrim fëmijët nëpër koncerte, mjafton t'm'i dërgojnë mua ose njërit të bashkisë, ne menjëherë i nxjerrim, menjëherë i promovojmë, kjo është gënjeshtër, marrëdhënia e dikujt me bashkinë që e sheh bashkinë si mish i huaj është problemi i atyre. Bjereni njëherë për publikim një rezultat dhe shihni publikohet apo s'publikohet, nëse ndodh njëherë që s'publikohet ne përgjigjemi, nuk ka ndodhur, zero rast, kur është dhënë ju lutem shumë filan ekip ka arritur këtë rezultat pozitiv dhe ne menjëherë e kemi nxjerrë, çka është në territor të Lezhës, s'ka ndodhur kurrë, këto përrallat për kësi gjërash janë palidhje komplet, s'ka ndodhur.

**-Ndue Luli:** Kush është dakord me projekt vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro.

Zbatimin e tij do ta shohim në të ardhmen dhe diskutojmë pastaj.

Mendoj që të kalojmë tek projektvendimet shtesë të cilat kanë të bëjnë me tërmetin e nëntorit të 2019-ës, për të cilat folëm dhe në fillim.

Projektvendim "Për përcaktimin e strukturës së banimit dhe masës së përfitimit në vlerë monetare për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit, të cilët kanë zgjedhur që ndërtimin banesave ta bëjnë vetë".

Fjalën e ka kryetari i bashkisë.

**-Pjerin Ndreu:** Do bëj një sqarim këtu. Kemi një problematikë sensitive në këtë drejtim, janë 50 banesa individuale që nuk janë adresuar, I nderuar kryetar, mund të mbani qetësi në sallë, të lutem kur flas unë ose më thuaj ka mbyll këtu.

**-Ndue Luli:** E dëgjoi vetë anëtari,

**-Pjerin Ndreu:** Të lutem shumë, a mund të vësh qetësi në sallë që të flas unë të paktën e dëgjojnë sepse është një problem që afekton disa familje që janë në një problematikë të rëndë, dhe e kemi marrë në dorë ne si bashki për ta adresuar dhe kjo është risia e vetme në Shqipëri që ndodh, janë 50 familje që nuk është adresuar problem për shkak jo të mos disponimit të qeverisë,

por për shkak të luftës që ndodhi në Ukrainë dhe rritjes së çmimeve dhe pamundësisë së firmës për t'i ndërtuar me ato shifra që i mori me ato manual, tashti me qeverinë kemi negociuar shumë kohë, akoma nuk na është dhënë e drejta që ne të shtojmë, tani ne kemi marrë vendim mbasi jemi konsultuar edhe me ministrinë e rindërtimit, me miratim në këshill, me miratim pastaj në ministrinë e rindërtimit, për ndërtimin e 50 shtëpive dhe ne do disponohemi me shtim duke bërë vlerësimet sipas manualit përkatës zyrtar të dalë sot dhe në këtë histori ne do të disponojmë 26 familje që kanë kërku që t'u jepen lekët dhe ne do ua japim, me dëshirën e tyre dhe e quajmë të ezauruar për 26 familje dhe 24 të tjera të cilët ne do hyjmë për t'u ndërtuar shtëpiatë në këtë situatë, do ta adresojmë në buxhetin që vjen, por tani na duhet ta çojmë vendimin në KSHR që ne të marrim miratimin në ministri të rindërtimit për të hap procedurë, dhe kuptohet do e bëjmë në programin e strehimit. Në programin e strehimit ne në burimet e të ardhurave që vijnë për shkak të lejeve të ndërtimit që janë në proces, njëra është zbardhë këto ditë, disa të tjera do zbardhen, ne e plotësojmë shumë, pra nëse ka një program strehimi që ne e kemi plagë në Lezhë është kjo dhe ne e mbyllim këtë histori duke pasur parasysh edhe pallatin këtu te ura që e kemi në procedurë tashmë, është adresuar fondi dhe besoj se shumë shpejt fillojnë punimet, kështu që mendoj dhe sugjeroj që ky projekt vendim nuk ka nevojë për ndonjë debat, kush ka ndonjë problem me e thënë ta thotë, por është një gjë që ne mezi po e presim, çdo këshilltar duhet të jetë i përgjegjshëm për të ngritur kartonin, për të thënë po dhe për të mbyllur një histori të cilën ne si Lezhë duhet ta mbyllim. si e para bashki në Shqipëri që i vë kapakun kësaj historie të dhimbshme të tërmetit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit, fjalën e ka kryetari i komisionit.

**-Agostin Marku:** Tani krejt shkurt, pasi disa gjëra të cilat mund të sqaroheshin, i sqaroi kryetari i bashkisë, ne në komision e diskutuam, në parim ishim dakort, është pozitiv fakti, përveç atyre që tha kryetari i bashkisë, ne që tani fillojmë konkretizimin me miratimin e këtij fondi, pra për këtë vit, me pjesën e 26 familjeve që duan t'i ndërtojnë vetë dhe u jepet paradhënie rreth 60% në momentin e lidhjes së kontratës dhe ky fond i gjithi mbulohet me fondin buxhetor se përveç se janë këto dy ndarjet që janë 26 dhe 24, është dhe projektvendimi përkatës ku janë burimet e financimit dhe miratohen për t'i konkretizuar dhe për të dhënë mbështetjen financiare. Ndaj t'i diskutojmë të gjithë së bashku, edhe në qoftë se ka diskutime se të tre një linjë kanë, se ato miratohen një nga një. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit. Kush ka ndonjë mendim? Zonja Marku.

**-Alfrida Marku:** Nëse ka diskutim edhe projektvendim me rëndësi, pa diskutim që ka efekt të jashtëzakonshëm, dhe është pikërisht ky hap që hidhet për konkretizimin për t'i dhënë zgjidhje problemit të zgjatur të këtyre 50 familjeve, të cilat për hir të së vërtetës në këto 6 vite, jo vetëm u përballën me atë situatë të vështirë por u gjendën edhe përballë pasigurive të mëdha. Kështu që unë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë këtë hap dhe këtë projektvendim të paraqitur nga Bashkia Lezhë dhe gjej rastin që t'u kërkoj përfaqësuesve të Bashkisë Lezhë që me po të njëjtën vëmendje të ndjekin edhe një tjetër problematikë që lidhet me rehabilitimin e pasojave që kanë

ardhur nga tërmeti, që është pikërisht pajisja e familjeve që kanë përfituar apartamente në pallatet e rindërtuara me dokumentin përkatës të pronësisë. Në këtë mbledhje u kërkoj përfaqësuesve të Bashkisë Lezhë që ta adresojnë këtë problematikë me autoritetin që kanë drejt ministrive përkatëse, drejt drejtorive përkatëse, me qëllim që edhe kjo problematikë të gjejë zgjidhje dhe që përfundimisht të themi që po, në Bashkinë Lezhë u rehabilituan të gjitha pasojat e tërmetit, duke mos harruar edhe pallatin që vetë kryetari i bashkisë e përmendi. Faleminderit.

**-Ndue Luli:** Kryetari e ka fjalën.

**-Pjerin Ndreu:** Për pallatin pas turizmit, është në fazën e lidhjes së kontratave sepse ka një problem. Pronari i pallatit është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ne do e kishim kryer më shpejt si procedurë por ata kanë ato ciklet e veta dhe do marrin hipotekat të gjithë. Ndërkohë që jemi në kontakt për pallatin te lagjja Gurra, do mbyllet dhe ai proces. Shumë mirë bërë që e ngrite si problem. Problemi më i madh është që qeveria e ka stopuar dhënien e fondeve dhe asnjë bashkinuk ka përfitu. Atëherë në këto kushte ne si bashki do hyjmë me fondet tona. Duhet ta adresojmë. Është program shqeto strehimi. Në qoftë se buxheti i bashkisë në programin e strehimit ka qark lekë, sot nuk ka një akt normativ që të specifikojë mënyrën e përdorimit. Atëherë ne do i adresojmë te familjet në nevojë për strehim. Është debat dhe mes stafit tonë, njerëzit më në nevojë janë ata që nuk kanë shtëpi, që ua kemi shembur. Do vlerësojmë edhe një program tjetër që ju e dini, që do jetë po me donacion që ne të japim një shumë dhe të ndërtojmë disa shtëpi për jetimët, pra të hyjmë në marrëveshje, po kjo do shikohet më vonë, ky muhabet duhet të adresohet sot, ne nuk kemi si e mbajmë më si patate të nxehtë në dorë.

**-Ndue Luli:** Atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë tek projekt vendimi tjetër “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 49, datë 07.03.2021 “Për përcaktimin e strukturës së banimit të banesave individuale për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit të cilët kanë zgjedhur që rindërtimi i banesave të tyre të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 të bëhet nga autoriteti shtetëror i caktuar me vendim të këshillit të ministrave”. Kush është dakord me projekt vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro. Faleminderit.

Në funksion të dy projektvendimeve të para është projektvendimi i tretë që ka të bëjë me financimin, projekt vendim “Për një ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe buxhetit për vitin 2025””. Kush është dakord dhe me këtë projekt vendim? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë tek dy informacionet. Informacioni i parë ka të bëjë me ecurinë e sezonit turistik për plazhet publike të menaxhuara nga Lezha Invest shpk, që e keni patur të gjithë.

**-Besmir Frroku (administrator i Lezha Invest):** Informacioni ka qenë i përgatitur përpara dhe ka qenë në dispozicion të këshilltarëve. Në mbledhjen e kaluar, kryetari bëri një sqarim shterrues në lidhje me këtë, me sa e ndoqa mbledhjen. Po bëj një shpjegim të shkurtër. Menaxhimi këtë vit ka ardhur në funksion të ndryshimit të VKM-së që ndodhi në vitin 2024, duke na dhënë mundësinë edhe nëpërmjet vendimit të këshillit bashkiak, që na ka kaluar disa zona për menaxhim. Ne e ndamë në 3 zona sipërfaqen e pasqyruar edhe në relacionin përkatës, në zona të pamanaxhuara, në zona të lira pa pagesë të menaxhuara me sistemin e pastrimit dhe zona të menaxhuara nga ana jonë, me të gjithë komponentët që plotëson një stacion plazhi. Ne kemi kërkuar nëpërmjet prokurimeve të kontraktuara 2600 çadra, duke parë dhe nevojat, edhe specifikat, edhe pozicionimin e stacioneve të plazhit dhe në vijim të tyre kemi përgatitur gjithë infrastrukturën, punonjësit, life guard security, boat, tabelat orientuese me çmimet përkatëse dhe gjithsej kanë qenë 21 stacione plazhi me 55 punonjës. Të gjitha stacionet e plazhit kanë qenë të pajisura me kasën fiskale dhe faturimi ka filluar që në momentin që është hapur stacioni i plazhit. Të ardhurat totale për periudhën qershor-gusht kanë qenë 31.525.600 lekë. Shpenzimet direkte kanë qenë 12.423.773 lekë. Fitimi Neto ka qenë 19.101.827 lekë.

Në gjykimin tim si administrator, menaxhimi i plazheve ka funksionuar mirë. Nuk kemi pasë asnjë fatkeqësi, mbytje në të gjitha stacionet e plazhit. Kemi pasë transparencë në lidhje me çmimet. Kemi pasë ankesa që i kemi adresuar në mënyrë të menjëhershme. Në fillim fare kanë qenë në lidhje me abuzimin me çmimet por pastaj kanë qenë disa ankesa nga më të çuditshmet që i shpjegoi edhe kryetari mbledhjen e kaluar, por që i kemi trajtuar.

Në mënyrë të përmbledhur këto kanë qenë, në qoftë se ka ndonjë paqartësi, jam i hapur.

**-Ndue Luli:** Faleminderit, kush ka ndonjë problem? Po zoti Marku.

**-Gjon Marku:** I nderuar kryetar i këshillit, të nderuar këshilltarë, në këtë seancë timen të parë dua të falenderoj të gjithë ata që më dhanë mundësinë të jenë pjesë e këtij këshilli, dua ta ndalem shkurtimisht mbi relacionin turistik që është paraqitur nga Lezha Invest. Dokumentacioni i paraqitur ka disa pasaktësi, tek shpenzimet janë paraqitur disa zëra të shpenzimeve, një ndër to është edhe çadra dhe shezllone për plazhet publike me vlerë 18 milionë lekë dhe tek tabela e të ardhura-shpenzime, nuk është pasqyruar, është një shpenzim operativ që duhet të ishte pasqyruar, sepse fitimi neto thotë 19 milionë lekë, si dhe tek shpenzimet direkte, paga plus sigurime dhe TVSH-ja nuk zënë vend tek ky zë, TVSH-ja nuk është shpenzim, kaq kisha për pjesën e kësaj.

**-Ndue Luli:** Po, fjalën nënkryetarja e bashkisë.

**-Brikena Vuksani:** Përshëndetje të gjithëve, po ta shikosh materialin me vëmendje, ke në mbledhjen e muajit mars që kemi bërë për transferimin e fondeve për Lezha Invest 30 milionë lekë nga fondet e bashkisë, pjesa e parë është se si janë shpenzuar këto fonde të Bashkisë Lezhë që Bashkia Lezhë ia ka transferuar Lezha Invest-it për shpenzime, konkretisht për kasat fiskale, për boba, pajisje për pikat e vrojtimit, shërbimi i marrjes me qira të shezlloneve dhe blerja vegla pune si dhe koshat e mbeturinave. Këto kanë qenë pjesa fillestare e kostove fillestare që duheshin

për të vënë në funksion një stacion plazhi me të gjitha shërbimet minimale që mund të ishin gjatë vitit të parë që operon Lezha Invest, pastaj në pikën e dytë ku shpjegohen të ardhurat dhe shpenzimet e Lezha Invest janë vetëm me të ardhurat e veta që ka krijuar nga operacioni nga shfrytëzimi i këtyre stacioneve plazhi. Pjesa e TVSH-së për momentin nuk është paguar akoma sepse kanë bërë blerje, kanë bërë shitje dhe normalisht që pjesa e TVSH-së patjetër që është pjesë e shpenzimeve përveç pagave, por me të ardhurat e veta, Lezha Invest ka paguar vetëm pagat edhe sigurimet, që të gjithë punonjësit kanë qenë të paguar me pagë si pagat e punonjësve të bashkisë, me sigurime të rregullta, sipas procedurave të kodit të punës, me kushte pune, me ditë pushimi dhe me të gjitha kushtet e nevojshme për të siguruar punën nëpër stacione.

**-Ndue Luli:** Faleminderit, fjalën e ka zoti Tushaj.

**-Pjeter Tushaj:** Se është diskutuar vjet, vendimi për hapësirat publike, unë kam qenë skeptik, me thënë të drejtën, por meqenëse jetoj atje dhe punoj atje, nuk flas në përgjithësi për pjesën ekonomike se si janë këto gjërat, nuk mund t'i vlerësoj, se s'jam në atë fushë. Por unë dua të them që unë kam pasur pushues edhe nga hoteli im që kanë shkuar në hapësirën publike edhe në Shëngjin, flas për pjesën brenda, kush ka pasë dëshirë dhe nevojë për të shkuar në hapësirën publike në plazh publik, ka qenë e gjithë mundësia për të shkuar. Pastaj, pjesa tjetër e menaxhimit e këto, s'e di, nuk mund të flas, por për pjesën që shkohet, njerëzit që duan me shku në hapësirën publike kanë pasur të gjitha mundësitë me shku. Pastaj, viti i parë nuk bëhet fjalë që mund të menaxhohet shumë më mirë, shumë më mirë, pjesa e vrojtuesve, të gjitha pjesët kanë qenë se ne kemi komunikim të përbashkët me këtë pjesë. Kurse pjesa e financimit e ekonomisë nuk e di me thënë të drejtën, po pjesa kush ka dashur me shku në plazh ka shkuar në publik, kush ka qenë në hotel ka shkuar në çadër të hotelit, pjesa tjetër që s'ka dashur ka shkuar.

**-Ndue Luli:** Faleminderit, zoti Pjetër, fjalën e ka kryetari i bashkisë.

**-Pjerin Ndreu:** Një sqarim për këtë histori. Kjo është, siç e tha dhe Pjetri, jam dakord me këshilltarin, është përpjekja e parë, viti i parë, normalisht nuk ka shkuar vaj gjithçka, po fakti që jemi sot me një organizim me fitim do të thotë që ne kemi ndërtuar themelet e një organizimi produktiv dhe që ka dhënë rezultate edhe në terren me gjithë defektet që i dimë dhe i kemi evidentuar dhe kemi menduar, për shkak të kësaj dhe për shkak të përsosjes së infrastrukturës atje në stacionet e plazhit, që kjo shumë t'i ngelet, në këshill do vijmë ne, t'i ngelet për shpenzime të mëtejshme, po Lezha Investit, dhe mendoj se jemi bashkia, pa modesti, e para model në Shqipëri që kemi ndërtuar një sistem të këtij lloji që është marrë shembull, shembull se si është organizuar me fitim. Tani aty në terren, mos kujto se e kemi kaluar kështu me daulle e me aheng, njerëzit nuk e kanë kuptuar në fillim, kanë dashur mos me e kuptu disa të tjerë, na është dashur me hy me gjuhën e ligjit, me gjuhën e vendosmërisë, dhe me çliru hapësirat, mos të harrojmë se këtë vit që vjen ikin kontratat pesëvjeçare, domethënë çlirohet zona sidomos aty përballë teje, komplet çlirohet zona e Kunes, sepse janë kontratat pesëvjeçare që nuk do jenë më, përveç hotelerive. Hoteleritë, jemi duke diskutuar, kemi bërë një takim me kryeministrin online, kryetarët e bashkive të bregdetit, kemi lënë një takim fizik me të për të shikuar disa elementë që

kanë të bëjnë me hoteleritë, sepse na ka ndodhur një fenomen pak shqetësues, hoteleritë kanë marrë me raportin një me dy dhe ka qenë propozimi im personal ç'është e vërteta, kanë marrë raportin një me dy, kanë pasur shezllone bosh, kanë vu çmimet që kanë dashur vetë, këtë do ta eliminojmë ne, hoteleria nuk mund të marrë shezllone e t'i lërë të lira e të vendosë pastaj çmimin si të dojë vetë. Shezllonet nuk janë mjet fitimi më, që të jemi të qartë. Unë do i propozoj qeverisë që komplet të kompensojë privatizimet e rërës, t'i shpronësojë të gjitha. Ne kemi treguar se jemi të zotë për ta bërë këtë punë. A ka defekte, a ka probleme, a ka gjëra që nuk shkojnë, a ka mosdhënie shërbimi korrekt? Po, ka. Por viti që vjen do të korrektojë gjithë këtë dhe ne nuk kemi pse mos të jemi optimistë për atë që kemi nisë. Asnjë bashki nuk e ka bërë këtë që kemi bërë ne. Ne u kemi dhënë mundësi beachbareve që ta bëjmë, por me kusht, çmimi sipas nesh, është vjelë nga bashkia me kasa fiskale dore, jo lekë xhepi. Ne i kemi monitoru, drejtorja e taksave me Lezha Invest, me polici bashkiake, me polici rendi, herë pas here kanë kry sondazhe, sa ke pre e sa ke, derisa i kemi sjellë në një normalitet. Prapë ka abuzime. Besoj që duke ardhë e duke u shtrëngu këto punë. Atje në terren, Lezha ka, sipas vetë ministrisë së turizmit dhe zyrës së bashkëqeverisjes, ku merr impaktet e ankesave kryeministri, ka numrin më të papërfillshëm të ankesave përsa i përket menaxhimit në plazhe, më të papërfillshmin në Shqipëri.

**-Ndue Luli:** Fjala për zonjën Marku.

**-Alfrida Marku:** Në fakt kur po diskutonim mënyrën e menaxhimit të plazheve publike, unë kam qenë ndër anëtarët e këtij këshilli që në disa detaje se si ishte shkruar dhe se si do të zbatohet, isha skeptike, për të vetmin qëllim apo për të vetmen arsye, se në këshill bashkiak gjithmonë kam mbrojtur interesin publik edhe asnjëherë nga mbledhja e parë te e fundit, nuk do më dëgjoni duke mbrojtur interesat e mia. Me atë çfarë unë kam konstatuar, mënyra se si plazhet publike janë menaxhuar në këtë vit fillestar, pra është viti i parë i një eksperience që unë shpresoj do të jetë e gjatë, është pozitive, duke mos harruar që patjetër duhet të ketë përmirësime në disa elementë konkretë. Unë e vlerësoj mbi të gjitha një fakt se në titrat e mediave të ndryshme, plazhet e Lezhës asnjëherë nuk dolën në këtë sezon për humbje jete dhe këtë mbi të gjitha e vlerësoj si arritje të menaxhimit të plazheve. Kam arritur me kuptu diçka edhe me vu theksin se çfarë është publike është e qytetarëve dhe çfarë është publike që të jetë e qytetarëve është përgjegjësi e institucioneve dhe në këtë rast e bashkisë, kështu që unë mendoj se sikur se me plazhet që t'ia rikthejmë qytetarëve, unë mendoj që Bashkia Lezhë duhet të jetë më këmbëngulëse edhe sa i përket rikthimit tek qytetarët të hapësirave publike të zëna në mënyrë të padrejtë ndër vite, edhe duke ndjekë shembullin e përfaqësuesve, drejtuesve të Lezha Invest që erdhën këtu me një relacion të detajuar, unë do të kërkoja nga drejtorja e Urbanistikës edhe nga policia bashkiake dhe nga strukturat e tjera përgjegjëse të Bashkisë Lezhë, që në mbledhjet e radhës të vinin me një relacion po kështu të detajuar mbi metrat katrorë që na përkasin ne, qytetarëve të Lezhës, të zëna padrejtësisht ndër vite nga individë apo biznese të cilat janë liruar në këtë aksionin e kohëve të fundit. E përsëris çfarë është publike i përket qytetarëve dhe çfarë është publike që të jetë e qytetarëve është përgjegjësi e institucioneve, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Faleminderit, ka mendim tjetër në lidhje me informacionin, zoti kryetar.

**-Pjerin Ndreu:** Kjo është një risi shumë madhe në mënyrën e famshme të dyshimit për gjithçka, në gjithë atë furtunë që ke ngritë këtu që gjithçka këtu është e zezë e bëhet zi, domethënë shyqyr që erdhe dhe the po e bëme një gjë, shyqyr zotit, është për tu përshëndet, faleminderit që ke ardhur aty, sepse është një shërbim që i shërben qytetarëve siç e the dhe unë nuk jam kundra edhe për hapësirat publike tani që po marrim në dorë ne dhe që fatkeqësisht shumë na dalin të legalizuara, fatkeqësisht na dalin të legalizuara, mos kujto se s'i kemi marrë në sitë të gjitha, por nga që fenomeni i kërpudhave ngjitet me pallatet dhe përtej pallateve, ka kohë që ka filluar, vite të tëra, ne kemi një problem tashmë se shumë prej tyre janë legalizuar, me ligj apo pa ligj ne do marrim tani verifikimin e të gjithave dhe do i denoncojmë për legalizime të paligjshme, dakort dhe do kërkojmë rregjistrimin e tyre nga legalizimet, sepse dëmton rëndë funksionimin e qytetit dhe e dëmton në fakt, por është një kosto që nëse e rrëzoj unë, nesër duhet me pagu lekë se ai tjetri e ka prone. Jam shumë dakort që të vijë, ne po vazhdojmë aksionin, do dal vetë në këmbë një ditë në qytet në këmbë e hiqeni mendsh, metoda e shembjes është mënyra më e mirë me marrë vota. Dhe nuk ndalemi as para këtij, as para atij, as para kësaj, as para asaj, do hyjmë ta bëjmë.

**-Ndue Luli:** Para se të shkojmë te pika "Të ndryshme", keni përpara të gjithë një raport të komisionit të barazisë gjinore dhe çështjeve sociale, që ka të bëjë me barametrin gjinor në Bashkinë Lezhë, kështu që materialin e ka pasur secili vetë, është i kuptueshëm për secilin. Kalojmë te pika "Të ndryshme", zoti Jaku.

**-Dod Jaku:** Përshëndetje të gjithëve, unë desha të ngre një shqetësim të njësisë së Shënkollit, ky shqetësim është për gjithë Lezhën dhe sidomos për zonat rurale. Ne si këshill bashkiak edhe para rreth dy vjetësh e kemi trajtuar problemin e energjisë elektrike, në njësinë tonë dhe në shumë fshatra, domethënë ka dhe me ditë që mungon energjia elektrike për faktorë të pafund që burojnë dhe që janë shkaktarët e kësaj gjendjeje. Unë do i kërkoja këshillit bashkiak ose kryesisë në qoftë se është e mundur, ta marrim në analizë edhe si këshill bashkiak dhe mundësisht të kërkojmë ndonjë përfaqësues të OSHEE-së dhe të na japin ndonjë sqarim se me atë infrastrukturë elektrike që është në atë zonë kjo gjendje do vazhdojë përherë dhe s'ka njeri që ta përmirësojë po nuk u ndërhy në mënyrë drastike për tu sistemuar komplet sistemi elektrik, faleminderit.

**-Pjerin Ndreu:** Mirë atëherë meqenëse e ngrite në këshill, personalisht jam në kontakt me këtë situatë. Normalisht si punë nuk më takon mua, por meqenëse mbaj atë post që mbaj dhe mund të lëviz mekanizma, jemi në biseda me drejtorin e operatorit qëndror për të investuar zonën Rilë-Shënkoll, për të mbyllur Zejmenin dhe për të mbyllur nga Mërqia, njëherë për tre projekte shpejt e shpejt deri në Krajen. Më është premtuar, po bëhen projektet, duhet t'i ndjek vetë, sepse janë disa premtime që i kemi dhënë, po angazhohet edhe zoti Manja, kemi folur edhe me ministren, besoj se do të marrim vitin tjetër disa projekte të cilat do i rregullojnë disa pika, por këto tre pika e di të paktën që janë më të avancuara, i kam kërkuar edhe Ishull Lezhën, iu kam kërkuar që të futet në sistem për arsye të qenies një zonë elitë bashkë me zonën e agroturizmeve Fishtë-Troshan, pra ajo është adresuar, keni të drejtë për këtë, ky është një problem që ne duhet ta duhet ta shohim atë punë.

**-Ndue Luli:** Mendim tjetër, zoti Ndreu.

**-Artan Ndreu:** Zoti kryetar, te rruga e manatisë, te kryqëzimi, e kam ngritë edhe herë tjetër, është katastrofë ai rrethrotullimi i daljes te karburanti. Kanë ba ca vijëzime pa kuptim dhe bëhet çdo ditë trafik. Aty është dhe një objekt pa leje.

**-Pjerin Ndreu:** Do ta shohim atë punë, do shkojë një ekip ta shohim, problemi është që duhet të jemi të qartë për një gjë, qyteti kalon komplet në investim dhe problemet e trafikut do jenë një problem shumë i madh në qytet, ta dini mirë, nuk kemi çfarë të bëjmë, është një kaos pune, ju thashë tashi komplet situata zbret nga lagja e Spitalit poshtë në bulevardin "Gjergj Fishta", te rruga Luigj Gurakuqi dhe domethënë hapet qyteti komplet. Është ura e Cenit për t'u bërë, më mirë i kemi adresuar për një kohë sesa i bëjmë në kohë të gjatë dhe fillojmë hapim njëherë njërën vitin tjetër tjetrën, në vitin tjetër tjetrën, bëhet edhe duhet të ketë filluar bile këto ditë i kemi vu tabelat e kanalit te rruga Shtraus.

Bëhen disa punime të cilat do i bezdisin njerëzit, por duhet që njerëzit të eliminojnë sa të mundën makinat.

**-Ndue Luli:** Po zonja Marku.

**-Alfrida Marku:** Faleminderit, do parashtroj disa problematika të cilat më adresohen nga qytetarët.

Së pari, duke marrë shkas nga zjarri që ra në një pallat në lagjen Besëlidhja, në vijimësi edhe të problematikës që këshilltari Jaku sapo tha, unë mendoj që bashkia me autoritetin që ka duhet ta adresojë vlerësimin e gjendjes teknike të paketave elektrike në të gjitha pallatet.

Tjetër problematikë, që unë mendoj koha do ta evidentojë gjithnjë më shumë, është mungesa e shkallëve të emergjencës në pallate, normalisht ku bëhen ndërtime të reja është kusht i domosdoshëm, aty ku ndërtimet janë të mbaruara, ka mundësi që këto shkallë emergjence të sistemohen.

E kam theksuar dhe në mbledhje të tjera, është domosdoshmëri që Bashkia Lezhë, kuptohet edhe me mbështetjen e këshillit bashkiak, të ndërmarrë nismën për zgjedhjen e administratorëve të pallateve.

Një tjetër problematikë është mungesa e prezencës së punonjësve të policisë së shtetit pranë shkollave në qytetin e Lezhës, të paktën nga fillimi i këtij viti shkollor e deri më sot, unë kam vënë re mungesën e prezencës së tyre.

Një tjetër propozim, në fakt, që është edhe zgjidhje e një problemi, sa kohë është në proces rikonstruksioni i kanalizimeve në lagjen e spitalit, unë e kam shprehur dhe më herët, do ishte mirë që Bashkia Lezhë të ndërmerre nismën për të hartuar një projekt për rikualifikimin e plotë të asaj lagjeje, për t'i dhënë mundësi, pse jo, krijimit të një korpusi spitalor, aty tashmë është një

godinë re, plus është një godinë tjetër e rikonstruktuar, por janë disa objekte, magazina, pse jo dhe pallate të vjetra të tejamortizuara, që në mendimin tim, një nismë me peshë të madhe financiare, që jo vetëm Bashkia Lezhë mund ta mbulonte, një nismë rindërtimi, shembje dhe kompensimi e këtyre familjeve do të ishte mirë sepse do t'i jepte pa diskutim një trajtë tjetër lagjes së spitalit, do ta rikualifikonte në themel si dhe do të na jepte mundësinë që të kishim mirëfilli një korpus spitalor në këtë lagje, faleminderit.

**-Ndue Luli:** Ka mendim tjetër? Po zoti kryetar.

**-Pjerin Ndreu:** Për atë lagjen e spitalit, ka rrezik që bashkohemi me një ide se unë jam për t'i marrë ato familje sikur janë, tre pallata sa janë ato, për t'u dhënë mundësinë e shtëpive të tjera për t'i paguar ne dhe aty me bë një me bë e para një parking për spitalin në funksion të spitalit dhe e dyta me bë një shesh me i hap fare mos me bë ndërtim fare aty por me bë një shesh, një shesh për atë lagje, ku gjithë lagja të dalë se ata s'kanë ku dalin fare, s'kanë frymë, edhe vetëm kur dalin poshtë, edhe kur dalin poshtë, vijnë me makina e na bllokojnë trafikun ne, se s'na bëjnë asnjë punë tjetër.

**-Ndue Luli:** Problem tjetër? Nuk ka. Atëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe mirupafshim në mbledhjen e ardhshme.

**Shënim:** Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Floride Cunaq  
f

KRYETARI

NDUE LULI  
f